

## KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 14 / 01 / 2022, në Tiranë, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë :

**SHITËS:** Znj. **Valentina PRODANI**, e bija e Thimit, lindur në Durrës, më 28.07.1954, identifikuar me kartë identiteti me numër personal me numër personal F45728030R, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar [*në cilësinë e Shitësit*],

Dhe

**BLERËS:** **Z. Kujtim SPAHIU**, i biri i Fadilit, lindur në Tiranë, më 15.02.1957, identifikuar me kartë identiteti me numër personal F70215190B, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar [*në cilësinë e Blerësit*].

**OBJEKTI:** Shitja e 25.387 (njëzet e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) aksioneve të "BANKA CREDINS" sh.a, që zotërohen nga aksionarja Znj. **Valentina PRODANI** dhe blerja e tyre nga **Z. Kujtim SPAHIU**.

### **PËRMBAJTJA E KONTRATËS**

Shoqëria "BANKA CREDINS" SH.A., është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT K316088010 si dhe me licencën Nr.16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

**Shitësja**, Znj. **Valentina PRODANI** zotëron 25.387 (njëzet e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A. sic rezulton dhe vërtetohet nga dokumentet e shoqërisë.

### **ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS.**

Palët kanë rënë dakord që 25.387 (njëzet e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) aksione të shiten me cmim 1.69 euro/aksion dhe me vlerë totale 42.904 euro (dyzet e dy mijë e nëntëqind e katër euro).

Pagesa në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare dhe do të derdhet në llogarinë e Shitëses pranë Bankës Credins me nenshkrimin e kontrates.

### **MENYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE**



**Shitësja** është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë **Blerësit** 25.387 (njëzet e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A., që ajo zotëron në kapitalin aksionar të Bankës.

Nga ana e saj, **Blerësi, Z. Kujtim SPAHIU**, është plotësisht dakord të blejë 25.387 (njëzet e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A, të zotëruara nga shitësi në kapitalin aksionar të Bankës.

Kështu, me përfundimin e këtij transaksioni shitje **Z. Kujtim SPAHIU** do të zotërojë 166.757 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) aksione në Bankën Credins sh.a.

## LIGJI I ZBATUESHEM

Palët bien dakord që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen.

## TË TJERA

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke patur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar.

### SHITËSE

Znj. Valentina PRODANI

*Valentina Prodan*

### BLERËS

Z. Kujtim SPAHIU

*Kujtim Spahiu*